

**Të dashur studentë,
Te nderuar dekane ,
Të nderuar kolegë e bashkëpunëtorë**

Dëshiroj t'ju uroj të gjithëve mirëseardhjen në këtë ditë të parë të vitit të ri akademik 2011 – 2012. Ky vit akademik përmbledh në vetvete arritje e detyra por edhe mjaft simbolika.

Kam dëshirë që fillimisht të uroj të gjithë ata studentë që sot hyjnë për herë të parë si studentë në shkollën tonë. Dua ti siguroj ata se do të jenë pjesë e një familjeje të madhe, që do t'u gjendet pranë hap pas hapi në rrugën e formimit dhe përmbushjes së tyre artistike.

Njëkohësisht përgëzoj dhe gjej rastin të falenderoj për kontributin e vërtetë në zhvillimin e shkollës sonë, trupën pedagogjike dhe studentët. Ju falenderoj ju të nderuar kolegë për gjithçka bëni përditë për edukimin profesional të artistëve të rinj. Unë e çmoj shumë rolin tuaj të padiskutueshëm.

Sot, me fillimin e vitit akademik shkolla jonë është Universiteti i Arteve. Ndjem krenar që së bashku me kolegët e mi pedagogë dhe të gjithë bashkëpunëtorët tanë, dhe sigurisht me ndihmën e studentëve, arritëm që shkollën tonë ta ngremë në një nivel më të lartë institucional, duke synuar në rritjen e standardeve të ofertave tona akademike. Shëndërimi në Universitet përkon gjithashtu me një moment simbolik për shkollën tonë, duke na risjellë në mendje ngjarje që tashmë i përkasin historisë, por që janë bërë pjesë e traditës dhe e trashëgimisë sonë artistike e profesionale. 45 vjet më parë nisi viti i parë akademik në Institutin e Lartë të Arteve, një shkollë arti e krijuar nga bashkimi i Konservatorit Shtetëror të Tiranës, Shkollës së Teatrit dhe Shkollës së Arteve Pamore. Për kremtimin e këtij viti akademik jubilar ne kemi planifikuar dhe do të zhvillojmë një sërë aktivitësh.

Universiteti i Arteve ka filluar përmbushjen e sistemit 3 + 2, duke ofruar studime të ciklit të parë dhe ciklit të dytë sipas sistemit të Bolonjës. Oferta jonë akademike përfshin 32 programe studimi të shpërndarë sipas fushave në tre Fakultete, në përfundim të të cilave ju të dashur studentë do të mund të merrni diplomën Bachelor për ciklin e parë të studimeve (tre vjeçar) dhe diplomën Master i Arteve apo Master Shkencor e Master Profesional për ciklin e dytë të studimeve (+ 2).

Gjatë udhëtimit tuaj formues do t'ju jenë krah mbi 300 pedagogë, mes të cilëve spikasin një numër i madh emrash të shquar personalitetesh të artit shqiptar. Ky fakt përbën një pikë të fortë të Universitetit të Arteve në sigurimin e një cilësie të lartë në formimin artistik e profesional të studentëve. Në këtë këndvështrim duhet të jetë synim i yni kryesor që të shtojmë përpjekjet për ngritjen e nivelit të pedagogëve më të rinj si nga pikëpamja e mësimdhënies ashtu edhe nga pikëpamja shkencore. Qenia e Universitetit të Arteve na nxjerr detyra të mëdha për sa i takon fuqizimit të aspekteve shkencore të ofertës dhe veprimtarisë sonë akademike. Duhet të gjithë të bëjmë përpjekje që përveç se

art në Universitetin e Arteve të bëhet edhe shkencë e mirëfilltë, gjithmonë kjo e lidhur ngushtë me profilin tonë. Kjo do të na bëjë me të vërtetë të meritojmë emrin Universitet. Në këtë drejtim do të jenë një ndihmesë e madhe mjediset, sallat, ateliet e shkollës sonë, të cilat duhet të jenë gjithmonë të mbushura me veprimtari të shumëllojshme. Biblioteka shkencore e Universitetit të Arteve duhet dhe besoj se do të shndërrohet në një nga mjediset më të frekuentuara, ku të gjithë ne, studentë e pedagogë do të mund të gjejmë informacionet dhe materialin e nevojshëm për rritjen tonë profesionale, artistike e shkencore. Nëpërmjet projekteve të ndryshme Biblioteka shkencore është pajisur dhe vazhdon të pajiset me instrumentet e nevojshëm që janë në shërbimin tonë dhe si të tillë duhet ta shohim dhe ta shfrytëzojmë atë.

Gjithashtu këtë vit akademik do të kemi mundësi të përjetojmë mundësi dhe hapësira më të mëdha për shprehjen e aftësive krijuese e talentin e studentëve të Universitetit tonë. Angazhimi ynë do të jetë të krijojmë programe për mbështetjen e projekteve siç është rasti i Programit Qyteti i Arteve, i cili rezultoi i suksesshëm si në konceptim ashtu edhe në realizim. Programe të tilla do të nxisin studentët të rrisin përpjekjet e tyre në vazhden e formimit artistik e profesional si dhe do të shërbejnë për dallimin e talenteve dhe lidhjen jo vetëm me publikun por edhe me tregun e punës.

Kjo sigurisht që do të shoqërohet me rritjen e domosdoshme të standardeve në procesin e mësimdhënies nga njëra anë dhe të zhvillimit të jetës akademike nga ana tjetër. Të gjithë ne duhet ta ndjejmë veten tashmë si pjesë e një organizmi të madh, që për nga vetë profili dhe natyra e shkollës ofron dinamizëm të garantuar. E si pjesë e këtij organizmi kemi detyrimin të kontribuojmë qoftë edhe me elementët më të thjeshtë në përmirësimin e aspekteve të ndryshme të tij. Kjo mund të bëhet duke filluar që nga propozimi për forma e metoda të reja të mësimdhënies, të angazhimit të studentëve e pedagogëve, të formateve të orëve të mësimin, të mënyrave të lidhjes me aktorët e tjerë në shoqëri, të rritjes së nivelit të shërbimeve dhe mënyrës së dhënies së tyre, e deri në rregullimin e marrëdhënieve gjatë jetës akademike. Unë dëshiroj të theksoj se do të mirëpres çdo propozim, sa do të thjeshtë, që synon të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të shkollës sonë dhe do të jem i hapur për të diskutuar me të gjithë.

Për mua ky vit i ri akademik duhet të shënojë fillimin e një evolucion të rëndësishëm në konceptin dhe mentalitetin e edukimit artistik e shkencor në Universitetin e Arteve. Ne të gjithë duhet të jemi pjesë e këtij evolucioni, sepse vetëm kështu, edhe si individë mund të arrimë të zhvillohemi dhe të realizojmë sipërmarrje të suksesshme.

Ju uroj të gjithëve për një fillim të mbarë.

Faleminderit !